



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Senatit
Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Nr. Prot. 830
Dt 28.05.2018

Në bazë të nenit 48 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", si dhe në bazë të kërkesës së fakulteteve, Senati i Universitetit, në mbledhjen e mbajtur më 22.05.2018, mori:

VENDIM


- I. Aprovohen kërkesat e fakulteteve për lejimin e angazhimit të stafit akademik, për semestrin veror të vitit akademik 2017/2018.
- II. Angazhimi i mësimdhënësve për këto lëndë do të bëhet sipas përzgjedhjes së dekanatit, me kërkesë zyrtare të aprovuar nga prorektori për mësimdhënie, çështje të studentëve dhe kërkimeve shkencore.
- III. Obligohet zyra e personelit për përgatitjen e kontratës për angazhim të stafit të propozuar nga fakultetet dhe të aprovuara nga prorektori, sipas pikës I të këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Senati i Universitetit pasi shqyrtoi kërkesën e: Fakultetit të Teknologjisë Ushqimore nr. 297 dt. 02.03.2018; Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike nr. prot. 234 dt. 21.02.2018; Fakultetit Juridik nr. prot. 252 dr. 23.02.2018 dhe Fakultetit të Edukimit të paraqitur në mbledhjen e Senatit për lejimin e angazhimit të stafit akademik për semestrin veror të vitit akademik 2017/2018, e konsideroi të arsyeshme kërkesat, për arsye se në disa raste mësimdhënësit e angazhuar janë tërhequr, janë në pushim mjekësor pa afat, ose ka gabime teknike. Marrë parasysh se mungesa e mësimdhënësve për këto lëndë do të pamundësonte vazhdimin e mësimin, Senati vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it;
2. Fakulteteve;
3. Drejtorit të zyrës për çështje akademike;
4. Zyrës së personelit;
5. Zyrtarit ligjor.

Prof. asoc. dr. Alush Musaj

Kryesues i Senatit

